



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
BORDI DISIPLINOR

Nr. (•) i Vendimit

VENDIM

BORDI DISIPLINOR

i përbërë nga:

Jonida Gaba:	Kryetare
Entela Memishaj Shehaj:	Sekretar/ Anëtar
Irena Laha:	Anëtar
Marjana Semini-Tutulani:	Anëtar
Merita Prifti:	Anëtar

në seancën e datave (•), (•), (•) mori në shqyrtim kërkesën e Ministrisë së Drejtësisë, sipas Urdhrit Nr. (•), datë (•) "Për nisjen e procedimit disiplinor për noteren (•)", përcjellë me anë të shkresës Nr. (•) Prot, datë (•), me të dhënat si më poshtë:

KËRKUES:	Ministria e Drejtësisë
DREJTUAR:	Bordit Disiplinor, Dhoma Kombëtare e Noterisë
KUNDËR:	Subjektit të Procedimit (•), Notere
OBJEKTI:	Nisja e procedimit disiplinor për noteren (•); Marrjen e masës disiplinore të përcaktuar në gërmën dh) të nenit 26 të Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë".
BAZA LIGJORE:	Neni 26, 43-55 i Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë".

BORDI DISIPLINOR

pasi dëgjoi relatimin e Anëtares (•) dhe pasi përfundoi seancën dëgjimore me subjektin e procedimit disiplinor, Notere (•), përfaqësuesen e Ministrisë së Drejtësisë, përfaqësuar nga Znj. (•), Drejtore e Drejtorisë e Përgjithshme Rregullatore të Cështjeve të Drejtësisë dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

A. FAKTET

1. Bordi Disiplinor, Dhoma Kombëtare e Noterisë ("**Bordi**"), ka marrë në dorëzim Urdhrit Nr. (•), datë (•), të Ministrit të Drejtësisë, protokolluar me Nr. Prot (•) dhe përcjellë në Bordin Disiplinor me anë të shkresës Nr. (•) Prot, datë (•) ("**Urdhri Nr. (•)**"), sipas të cilit urdhërohet: *Nisja e procedimit disiplinor për noteren dhe dërgimi i dokumentacionit provues sipas Urdhrit nr. (•), datë (•) dhe Urdhrit nr. (•), datë (•), Bordit Disiplinor të Dhomës Kombëtare të Noterisë.*
2. Fillimi i hetimit disiplinor ka marrë shkas nga paraqitja pranë Ministrisë së Drejtësisë (MD), në rrugë elektronike, me email e ankesës datë (•) të (•) për përdorimin në mënyrë jo te rregullt të llogarive bankare nga ana e noteres, në kundërshtim me Udhëzimin Nr. (•), datë (•).

3. Pranë MD është depozituar me Nr. (•) Prot, datë (•), shkresa e "(•)" sha, mbi parregullsitë e verifikuara në transaksionet e kryera në llogaritë e mbajtura në emrin e noteres.
4. Ministri i Drejtësisë ka nxjerrë Urdhërin Nr. (•) datë (•) Për fillimin e hetimit disiplinor që i është bërë i njohur noteres, e cila ka nënshkruar marrjen dijeni në datën (•).
5. Gjatë ushtrimit të këtij hetimi, Ministri i Drejtësisë me Urdhërin Nr. (•), datë (•), ka vendosur "Për shtimin e objektit të hetimit disiplinor, në përputhje me nenin 6 dhe nenin 7 të Ligjit Nr. 8678, datë 14.05.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, nenin 22, nenin 23, pika 2, neni 25 dhe nenin 29, të Ligjit Nr. 110/2018 "Për Noterinë", si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë ushtrimin e veprimtarisë së Noterëve.
6. Nga grupi i kontrollit u kryen veprimet hetimore dhe u verifikuan aktet noteriale ku u konstatuan shkeljet e mëposhtme:
 - Kryerja e transaksioneve lidhur me cmimin e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, nga llogaria rrjedhëse në emër të vetë noteres. Depozitimi i çmimit të blerjes nga blerësi i pasurisë është bërë në disa raste në llogarinë e tjetërsimit dhe në disa raste në llogarinë rrjedhëse në emër të noteres në (•).
 - Nga verifikimi i kontratave të përcjella, nuk rezulton që raportimi pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave rezulton se raportimi është realizuar vetëm gjatë kryerjes së inspektimit për kontratat edhe kontratat e tjera të viteve të mëparshme, pra, jashtë afatit të detyrueshëm për zbatim nga noterët, si dhe jashtë çdo afati të arsyeshëm.
 - Nuk identifikohet momenti i fitimit të pronësisë dhe origjina e pronës, dhe/ose Noterja, ka bashkëlidhur certifikatën e pronësisë, në mënyrë që të evidentohet që kalimi i vlerës monetare nga ana e noteres nga llogaria e tjetërsimit në llogarinë bankare të shitësit është bërë brenda 24 orëve nga momenti i mbërritjes së certifikatës së pronësisë.
 - Noterja nuk shprehet për statusin civil të palëve dhe nuk përcakton nëse pasuria është e përfutur përgjatë martesës apo jo. Nuk heton dhe nuk bashkëlidh certifikatën familjare të datës së përfuturimit të pronësisë nga pala shitëse.
 - Noteri ka lënë pa plotësuar të dhëna në kontratë, ka lënë hapësira bosh të cilat janë të paplotësuara të datave të rifreskimit të kartelës, të numrit të llogarisë, etj.
 - Në veprimet noteriale me shtetas të huaj, noteri nuk ka përcaktuar nëse kupton ose jo gjuhën shqipe, nuk ka specifikuar në aktin noterial se kjo kontratë iu lexua shtetasit të huaj në gjuhën që ai kupton nga një përkthyes i licencuar.
7. Në seancën dëgjimore të datës (•), në prani të Noteres, ndër të tjera, u paraqitën pretendimet mbrojtëse e Noteres për raportin e MD, si më poshtë vijon:
 - Noteres nuk i është dhënë e drejta të dëgjohej. Grupi i Kontrollit ka filluar veprimtarinë e tij dhe ka hartuar raporte dhe konkluzione pa dëgjuar subjektin e proceduar.
 - Tërheqja e ankimit është depozituar përpara se Ministri i Drejtësisë të marrë vendim për shtimin e objektit të hetimit. Në rastin e tërheqjes së kërkesës Ministri i Drejtësisë mund të vendosë vazhdimin e hetimit vetëm nëse konstaton shkaqe për fillimin e hetimit kryesisht.
 - Hetimi ka filluar më datë (•) ndërsa vendimi për nisjen e procedurës disiplinore dhe dërgimin e dosjes hetimore në Bord është marrë 2 muaj pas përfundimit të afatit 6 mujor të parashikuar në nenin 28 të ligjit 110/2018 "Për noterinë". Ndërkohë, në rastin konkret nuk është vendosur fillimi i hetimit kryesisht dhe në vendimin për dërgimin e çështjes në Bordin e Disiplinës

- Grupi i kontrollit nuk ka ftuar subjektin e procedurës të paraqesë argumentet e tij. Veçanërisht në këtë rast subjekti kishte të drejtën të njihej me tërheqjen e kërkesës dhe provat e reja mbi bazën e së cilës Ministri i Drejtësisë vendosi të zgjerojë objektin e hetimit. Gjithashtu theksojmë se subjekti i proceduar nuk është njohur me ankimin e z. (•) dhe as me shkresën e (•) të sipërpërmendur në asnjë fazë të hetimit administrativ. Në rastin konkret procedura e njoftimit është kryer në kundërshtim me Kodit e Procedurës Administrative.
- Shkeljet për veprimet dhe aktet noteriale për verifikimin e pronësisë së palës mbi sendin e paluajtshëm janë tërësisht në kundërshtim me ligjin për noterinë. Detyrimi i noterit për verifikimin e momentit të fitimit të pronësisë nga pala shitëse nuk ka qenë asnjëherë një detyrim i shprehur ligjor. Gjithashtu, mbizotëron praktika që verifikimi i statusit civil kryhet në momentin e shitjes së pasurisë dhe praktikës së shitjes.
- Për shkeljet lidhur me transferimin e çmimit të shitjes noterja sqaron se *janë vetëm raste të shkëputura që nuk identifikojnë të gjithë praktikën noteriale të kryer ndër vite*. Përcaktimi i llogarisë rrjedhëse në vend të llogarisë së tjetërsimit për disa veprime juridike të caktuara është një gabim material i cili në asnjë rast nuk ka cënuar interesat e palëve apo të çenjë etikën dhe sjelljen profesionale të noterit. Gabimet lidhur me llogarinë bankare të depozitimit të çmimit të shitjes vijnë si rezultat i mungesës së bashkëpunimit dhe kryerjes me korrektësi të detyrave nga bankat e nivelit të dytë dhe në këtë aspekt Noterja është gatshme të korrigojë praktikën dhe të mospërsërisë të njejtat gabime.
- Përsa i përket mos përcaktimit të dhënave të palëve apo të llogarisë bankare në kontratat e shitblerjes së pasurisë, theksojmë se në çdo praktikë është bashkëlidhur kopje e dokumentit të identitetit dhe subjektet në të cilat janë konstatuar këto mangësi janë klientë të rregullt të zyrës, identiteti i së cilëve ishte i njohur nga noteria.
- Përsa i përket pretendimit se raportimet në DPPP sqarohet se detyrimi i subjekteve raportuese lind në momentin e përfundimit të transaksionit dhe pas përfundimit të marrëdhënies së biznesit dhe përmbushjes së detyrimeve nga palët.
- Noterja dhe nga kontrolli kryer nga vetë kjo ministri në kuadër të procesit të vetingut për noteret, vetëm disa ditë përpara fillimit të hetimit, ka marrë konfirmimin se është në rregull me praktikën e saj.

8. Në seancën dëgjimore, Noterja e pyetur në lidhje me llogaritë e saj si Person Fizik, ashtu dhe me llogarinë e dedikuar për transaksione noteriale, u shpreh se të gjitha llogaritë i janë mbyllur nga banka (•) sha dhe pranë kësaj Banke nuk ka asnjë llogari të hapur.

9. Në seancën dëgjimore, Noterja e pyetur në lidhje me tërheqjen e vertetimit bankar për të gjitha llogaritë, u përgjigj se Banka (•), nuk i është përgjigjur kërkesës së saj për ti vënë në dispozicion vërtetimin bankar për llogaritë e saj pranë kësaj banke dhe veprimet me këto llogari bankare.

B. Analiza Ligjore

10. Nga të gjitha aktet e shkruara dhe deklaratimet e palëve rezulton në mënyrë të përmbledhur se baza ligjore e cila rregullon veprimet dhe mosveprimet e kryera nga noterja që kondsierohen shkelje janë:

- **Për akte dhe veprime noteriale që hartohen dhe nënshkruhen nga shtetas të huaj:** Nenet 43, 44, 100, të Ligjit Nr. 7829 datë 01.06.1994 “Për Noterinë”; Neni 4, i Ligjit Nr.8337, datë 30.4.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqesore, pyjore, livadheve dhe kullotave”; **nenet 5-10 të Ligjit Nr.7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”.**
- **Për verifikimin e së drejtës së pronësisë dhe të origjinës së fitimit të saj në aktet noteriale që kanë në objekt kalimin e së drejtës së pronësisë është shkelur Neni 49(dh) ë), 54 të Ligjit Nr. 7829 datë 01.06.1994 “Për Noterinë”; Nenet 73, 74, 76, 90 dhe 94 të Kodit të Familjes.**

- **Për të gjitha rastet kur mungesa e të dhënave që lidhen me identitetin e palëve, specifikimin e sendit, dhe kushte të tjera thelbësore** Nenet 67, 105 të Ligjit Nr. 7829 datë 01.06.1994 “Për Noterinë”,
- **Për të gjitha rastet kur konstatohet mospërdorimi i llogarisë së dedikuar të noteres** Neni 105/4 i Ligjit Nr. 7829 datë 01.06.1994 “Për Noterinë”, parashikon në nenin 43, 44,49, 54 dhe 67 dhe pikat 1,2,3,6, 9 të Udhëzimit Nr.6915/2, dt.30.01.2012 “Mbi procedurat teknike për derdhjen e pagesës së tjetërsimit në llogarinë bankare të noterit” (në fuqi në kohën e kryerjes së inspektimit),
- **Për të gjitha rastet kur mungon verifikimi i certifikatës së martesës i statusit të palëve dhe i rregjimit pasuror të bashkëshortëve që janë palë në kryerjen e veprimit juridik** Nenet 127/1 dhe 105/5 i Ligji Nr. 110/2018 “Për Noterinë”:
- **Për rastet kur nuk janë përmbushur në afatin e duhur detyrimet për deklarimin e veprimeve noteriale në DPPPP** Neni 11 i Udhëzimit Nr. 29 datë 31.12.2012 “Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të profesioneve të lira jofinanciare”

C. Vlerësimi i Bordit Disiplinor

11. Bordi Disiplinor vlerëson se janë kushtet për fillimin dhe vijimin e procedurës disiplinore sipas Urdhrit Nr. (•), Nr. (•) Prot, datë të Ministrit të Drejtësisë.

12. Fillimi i hetimit disiplinor ka marrë shkas nga paraqitja pranë Ministrisë së Drejtësisë, të ankesës në rrugë elektronike me email për kryerjen e një inspektimi për shkak të përdorimit në mënyrë jo të rregullt të llogarive bankare nga ana e noteres në kundërshtim me Udhëzimin Nr. (•), datë (•).

13. Fillimi i procedurës disiplinore ndaj Noterit (•) i ka nisur nga Ministri i Drejtësisë me Urdhrit Nr. (•), datë (•), “Për nisjen e procedimit disiplinor për noterin (•)” në kuptim të gërmës dh) të nenit 26 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”.

14. Procesi disiplinor është zhvilluar me seancë dëgjimore publike të realizuar në tri ditë. Përbërja e Bordit Disiplinor nuk është kundërshtuar nga palët paraprakisht ose në fillimin e seancën dëgjimore kur është pyetur nga Kryetarja e Bordit Disiplinor.

15. Seanca e parë u shty për shkak të paraqitjes së raportit mjekësor nga subjekti i procedimit disiplinor, për t’u zhvilluar në datën (•).

16. Në seancën e datës (•), u paraqitën palët. Noterja depozitoi parashtrimet e saj me shkrim dhe provat. Përfaqësuesja e MD kërkoi kohë për t’u njohur me parashtrimet. Të dyja palët kërkuan respektivisht kohë të paraqesnin provat të tjera.

17. Në seancën e datës (•) u mor një vendim i ndërmjetëm i Bordit Disiplinor, ku u vendos: Pranimi i provave të depozituara dhe shtyrja e seancës dëgjimore me qëllim: administrimin e informacionit shtesë nga (•) Sh.A; Marrja e provave shtesë nga noterja lidhur me llogaritë e saj, nga data (•) deri në datën e mbylljes dhe sqarime rreth veprimit noterial të kryer me noteren tjetër (•). Bordi ju drejtua me shkresë edhe (•) për informacion për llogarinë banakre të dedikuar dhe atë personale të noteres;

18. Në seancën e datës (•), u paraqitën provat shtesë dhe u ridëgjuan palët. Bordi Disiplinor konstatoi se (•) nuk ktheu përgjigje. Po ashtu, Noterja nuk paraqiti statement bankare të printuara. Noterja paraqiti urdhërpagesat që lidhen me transfertat për llogari të kontratës me Nr. (•) Rep dhe (•) Kol, me datë(•), me notere (•), si dhe një deklaratë noteriale për të dëshmuar pse i kishte këto lekë në llogarinë e saj dhe

urdhërpagesat që vërtetonin transfertat e saj nga llogaria personale si person fizik (jo llogaria e dedikuar e noteres) për llogari të aktit noterial.

19. Në seancën e datës (•) avokatja e noteres bëri një koment me gojë drejtuar anëtares së Bordit Disiplinor Znj. (•) që linte të kuptohej se kjo anëtare po paragjykonte veprimet e Noteres. Për sa më sipër, Znj. (•) paraqiti në kërkesën e saj për përjashtimin nga procesi vendimmarrës, meqënëse pala në proces, ngriti dyshime për paanshmërinë e saj. Me vendimin e ndërmjetëm (•) Bordi Disiplinor me unanimitet të katër atëtarëve të tij vendosi rrezimin e kërkesës së anëtares për tu dorehequr nga vendimarrja në lidhje me procedimin disiplinor kundër Notere (•).

20. Nga analiza e dosjes dhe nga hetimi disiplinor Bordi vëren se shkeljet e konstatuara nga Raporti Hetimor, janë shkelje të njëpasnjëshme dhe të disallojshme si: **Akte dhe veprime noteriale me shtetas të huaj**, pasi nuk ka specifikuar në aktin noterial se akti iu lexua shtetasit të huaj në gjuhën që ai kupton nga një përkthyes i licencuar; **Për verifikimin e pronësisë dhe të origjinës së saj në aktet noteriale që kanë në objekt kalimin e të drejtës së pronësisë; Mosverifikimi i certifikatës së martesës dhe i statusit të palëve, rregjimi pasuror martesor i bashkëshortëve që janë palë në kryerjen e veprimit juridik.** Aktet e Noteres (•) rreszikojnë që ato të jenë potencialisht të pavlefshme; **Mungesa e të dhënave që lidhen me identitetin e palëve, specifikimin e sendit dhe kushte të tjera thelbësore; Mospërdorimi i llogarisë së dedikuar të noteres; Mospërbushja në afat e detyrimeve për deklarimin e veprimeve noteriale në DPPPP.**

21. Bordi Disiplinor i gjen të pabazuara në ligj apo në provë pretendimet e Noteres lidhur me procedurën dhe përmbajtjen e akteve noteriale (•) dhe argumenton si më poshtë :

- **Lidhur me diskrecionin** në trajtimin e këtij rasti dhe kësaj procedure sqarojmë se:
 - a) **Parimi i diskrecionit në rastin e Ministrisë së Drejtësisë**, në veprimtarinë kontrulluese të ushtruar ndaj noterëve në RSH, sipas Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”, materializohet në nenin 25. Në optikën e rastit konkret dhe në zbatim të pikës 7 të nenit 25 dhe pikës 5 të nenit 26 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”, Ministri i Drejtësisë ka vepruar brenda kompetencës diskrecionale për të hetuar dhe për të dërguar rastin konkret për shqyrtim përpara Bordit Disiplinor.
 - b) Diskrecioni i Bordit është e drejta për të ushtruar autoritet publik për të përmbushur një qëllim të ligjshëm, në rastet kur ligji parashikon pjesërisht modalitetet për të arritur këtë, **duke i dhënë hapësirë vlerësimi zgjedhjeve të organit publik.** Organi publik duhet të vlerësojë se cilin opsion preferon dhe cili vendim duhet të merret në përputhje me rrethanat. Organi publik duhet të vendosë duke vlerësuar dhe balancuar interesat e prekura dhe duhet të marrë një vendim i cili është në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Organi publik duhet të japë arsyet duke shpjeguar pse diskrecioni është përdorur në mënyrën përkatëse, sipas shkronjën “d”, të nenit 100 KPrA.
- **Lidhur me Afatin e Hetimit.** Afati 6-mujor për hetim, parashikuar në nenin 28 të Ligjit Nr. 110/2018 është një afat i cili, në rast mosrespekimi nuk passjell ndonjë pavlefshmëri. Në cdo rast, duhet theksuar se është një afat që i shërben stabilitetit të marrëdhënies kontrollues-i kontrolluar. Në rastin në fjalë kemi Urdhrin e Ministrisë së Drejtësisë Nr. (•) datë (•) dhe më pas Urdhrin e Ministrisë së Drejtësisë Nr. (•)datë (•), sipas të cilëve fillimisht është hetuar për ankesën e një shtetasi, për një kohëzgjatje 3 mujore dhe me pas është hetuar për veprimtarinë e noteres në përgjithësi, për një kohëzgjatje 5 mujore. Në kuptim të nenit 28/2 të Ligjit Nr. 110/2018 shkeljet nuk parashkruhen për shkak të kalimit të afatit 6-mujor të përmendur në nenin 28 te Ligjit Nr. 110/2018 “Per Noterinë”. Është më rëndësi për të argumentuar në lidhje me rastet e mbylljes së hetimit, në kuptim te nenit 29 dhe 39 të Ligjit “Për Noterinë”, **tërheqja e ankesës nga ankuesi**

nuk përbën shkak për mbylljen e hetimit.

- **Në lidhje me pretendimin për pavlefshmëri të Urdhrave të Ministrisë së Drejtësisë**, rezulton nga procedimi disiplinor se gjatë hetimit, ka pasur një procedure të rregullt ligjore dhe Noterja ka pasur korrespondencë dhe takime me MD, ka shkëmbyer prova e ka dhënë qëndrimin e saj në lidhje me shkeljet e pretenduara. Si rrjedhojë, në castin që Noterja pretendon pavlefshmëri të një veprimi administrativ, ka detyrimin absolut të identifikojë pretendimin e saj, në të paktën një nga rastet e parashikuara nga nenet 108 ose 109 të KprA, gjë që noterja nuk e bëri dot.
- **Lidhur me të drejtën për tu dëgjuar**. Pretendimi se procesi i verifikimit të kryer nga MD ka qenë në një proces i parregullt ku nuk është respektuar e drejta për t'u dëgjuar, nuk qendron për shkak se në dosjen e përcjellë në Bord konstatohet se noterja është treguar aktive për të komunikuar me MD-në dhe grupin e punës, sepse në dosje rezultojnë shkresa me shënime "Mora dijeni", me datën dhe nënshkrimin e saj me emër dhe mbiemër; në shkresën me lëndë "Kthim përgjigje" Drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, po ashtu, në Inventarin e akteve noteriale për llogari të procesit disiplinor të kryer nga grupi i Punës i MD-së, po ashtu;
- **Lidhur me Pamundësinë e kundërshtueshmërisë së Urdhrave të MD-së Bordi konstaton se është e qartë që aktet administrative të lëshuar nga Ministri i Drejtësisë, përbëjnë akte administrative me natyrë të vecantë**. Sjellja e kërkesës së Ministrit të Drejtësisë përpara Bordit Disiplinor, nuk ndryshon asgjë në statusin e noterit, por përkundrazi përbën subjekt vlerësimi nga Bordi Disiplinor. Për urdhrat e MD-së, që përmbajnë kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, nuk ka parashikim në Ligjin "Per Noterinë", në lidhje me kundërshtimin apo ankimimin e tyre në rrugë gjyqësore, pasi nuk krijojnë apo ndryshojnë marrëdhënie juridike dhe as përmbajnë elemente urdhërimi apo të tjerë. Një e drejtë e tillë njihet dhe rezervohet për vendimin e Bordit Disiplinor, sipas nenit 52 të të njëjtit ligj dhe në kuptim të parimit të vendosur nga neni 21 i KPrA, paragrafi b).

22. Bordi Disiplinor pasi analizoi me kujdes faktet, bazën ligjore dhe raportin e Ministrisë së Drejtësisë, pasi dëgjoji parashtrimet e Noterit dhe të përfaqësueses së Ministrisë së Drejtësisë në seancën dëgjimore,

Konstaton se:

Janë konsumuar dhe kryer nga ana e noteres, të gjitha llojet e shkeljeve të evidentuara nga Ministria e Drejtësisë dhe të provuara në Raportet Hetimore dhe akte vijuese pasuese të tyre.

Shkeljet disiplinore të kryera nga notere (•) konsiderohen shkelje të rënda. Vecanërisht përdorimi i llogarisë rrjedhëse si person fizik në vend të asaj të dedikuar për transaksione noteriale, dhe aq më tepër tërheqja prej noteres e cmimit të shitjes të depozituar në llogarinë e saj dhe mbajtja për qëllime që nuk u evidentuan dot në këtë hetim disiplinor për një periudhë 3-4 javore para se të kalonin në llogarinë e shitësit, konsiderohet një shkelje shumë e rëndë.

Me veprimet dhe mosveprimet e kryera nga noterja çenohet legjislacioni në fuqi duke manifestuar sjellje dhe qëndrime që shkelin besimin e publikut dhe ulin dukshëm cilësinë e ofrimit të shërbimit të noterisë në vend.

Lidhur me parregullsi që lidhen me përmbajtjen e aktit noterial u konstatua se janë shkelur dispozitat e akteve të mëposhtme ligjore dhe nënligjore: Nenet, 43, 44, 100 të Ligjit Nr. 7829 datë 01.06.1994 "Për Noterinë", për akte dhe veprime noteriale që hartohen dhe nënshkruhen nga shtetas të huaj; Nenet 49/ë) dh), 54, të Ligjit Nr. 7829 datë 01.06.1994 "Për Noterinë", Kodi i Familjes i vitit 2003, Ligj Nr.8337,

datë 30.4.1998 “Për kalimin në pronësi të tokës bujqësore, pyjore, livadheve dhe kullotave” dhe Ligji Nr.7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve” për **verifikimin e së drejtës së pronësisë dhe të origjinës së fitimit të saj**; Nenet 67/ë) dhe 105/1/2/dh) të Ligjit Nr. 7829 datë 01.06.1994 “Për Noterinë”, **për të gjitha rastet kur konstatohet në aktet noteriale mungesa e të dhënave që lidhen me identitetin e palëve, specifikimin e sendit, dhe kushte të tjera thelbësore**; Nenet 105/4 të Ligjit Nr. 7829 datë 01.06.1994 “Për Noterinë”, si dhe pikat 1, 2,3, 6, 7, 9 Udhëzimi Nr.6915/2, dt.30.01.2012 “Mbi procedurat teknike për derdhjen e pagesës së tjetërsimit në llogarinë bankare të noterit” (në fuqi në kohën e kryerjes së inspektimit); **Për të gjitha rastet kur konstatohet mospërdorimi i llogarisë së dedikuar të noteres dhe mungesa e të dhënave për mënyrën e kryerjes së pagesë**; Nenet 105/5 dhe 127/1 të Ligjit Nr. 7829 datë 01.06.1994 “Për Noterinë”, **për të gjitha rastet kur mungon verifikimi i certifikatës së martesës dhe i regjimit pasuror të bashkëshortëve që janë palë**; Neni 11 i Udhëzimit Nr. 29 datë 31.12.2012 “Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të profesioneve të lira jofinanciare” - për rastet **kur nuk janë përmbushur në afatin e duhur detyrimet për deklarimin e veprimeve noteriale në DPPP.**

PËR KËTO ARSYE,

Bordi Disiplinor, Dhoma Kombëtare e Noterisë, mbështetur në nenin 51 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë” dhe nenin 11 të Udhrit të Ministrit të Drejtësisë Nr. 170 datë 10.06.2020 “Për miratimin e rregullores dhe skemën e kompesimit dhe funksionimin e Bordit Disiplinor”

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës të MD-së për fillimin e procedimit disiplinor ndaj Noteres (•);
2. Pranimin e masës së propozuar nga MD sipas 26/dh të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”;
3. Marrjen e masës disiplinore **Heqjen përfundimtare të licencës për ushtrimin e profesionit të noterit, në zbatim të gërmës “dh”, të pikës 2, të nenit 26, të Ligjit Nr.110/2018 “Për noterinë”**, për noteren (•);
4. Ngarkohet MD për nxjerrjen e urdhrit përkatës për zbatimin e këtij vendimi, duke parashikuar modalitetet për zbatimin e tij;
5. Ngarkohet DHKN-së, që në kuptim të nenit 54 dhe 55 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”, të bëjë publikimin e këtij vendimi dhe ta regjistrojë atë në regjistrin e masave disiplinore.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në gjykatën administrative të shkallës së parë Tiranë, brenda 45 diteve nga e nesërmja e komunikimit të këtij vendimi.

U shpall, në datë (•), në Tiranë.

Bordi Disiplinor Dhoma Kombëtare e Noterisë

**Jonida Gaba
Kryetare**

**Entela Memishaj Shehaj
Sekretar/ Anëtar**

**Irena Laha
Anëtar**

**Marjana Semini-Tutulani
Anëtar**

**Merita Prifti
Anëtar**